



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć
Ministry of Local Government Administration

Datë: 23.05.2013
Nr. 0204-549

PËR: Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Nijazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, Nr.01/011-4972, Pranuar me datë, 19.04.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.01/011-4972, të miratuar me datë 04.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi Nr.01/011-4972, për Lejimin e Shpalljes së Konkursit Publik për Dhënie në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës Komunale.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 23.05.2013
br. 0204-549

Za: Ramadan Muja, Gradonačelnik Opštine Prizren
Nijazi Kryeziu, Predsedavajući Skupštine Opštine Prizren

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE PRIZREN
, Br. 01/011-4972, Primitjeno dana, 19.04.2013

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br. 01/011-4972 usvojene dana 04.04.2013, **POTVRDUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt navaden u nastavku, ima puni pravni efekat .

- Odluka Br. 01/011-4972 , o dozvoli objavjivanja Javnog Konkursa za davanje na dugoročno korišćenje opštinske imovine.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanikpremijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima uprava MALS-a
Arhivi MALS-a.

Në bazë të nenit 5 dhe nenit 7. të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 12 pika c, nenit 14, alineja 1 dhe nenit 40, alineja 3, të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 alineja 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me 4 prill 2013, morri këtë:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E SHPALLJES SË KONKURSIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS KOMUNALE

Neni 1

Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënie e Pronës Komunale në Shfrytëzim, ashtu që lejohet shpallja e **konkursit publik** për këtë qëllim për pjesën prej - 711m/2 të ngast. Kadastrale nr. 07153-1 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme prej 27467m/2, që evidentohen sipas Certifikatës nr.6393, si PSH KK Prizren dhe për pjesën prej 629 m/2 të ngast. Kadastrale nr. 07155-1 ZK Prizren, prej sipërfaqe të përgjithshme prej 2920m/2, që evidentohen sipas Certifikatës nr. 6393, si PSH KK Prizren.

Neni 2

Ngastrat e përshkruara si në nenin 1 (për pjesët e të cilave lejohet shpallja e konkursit publik dhe atë për sipërfaqen prej 1340 (njëmijëtreqindëdyzet) m/2), që evidentohen sipas Certifikatës nr. 6393 dhe 6393, të datës 29 03 2013, si pasuri shoqërore KK Prizren.

Neni 3

Pronat në fjalë të përshkruara si në nenin 1 dhe 2, të këtij vendimi do të jepen në shfrytëzim me qëllim të realizimit të Planit Rregullues Urban Kuadranti F.6.2 të Qytetit të Prizrenit nr. 01/011-12652, të datës 15 nëntor 2012.

Neni 4

Afati Kohor për dhënie në shfrytëzim i pronës Komunale, do të jetë konformë nenit 3.1 të Ligjit Nr.04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës dhe do të jetë jo më tepër se 99 vite me të drejtë shkëputjes së kontratës edhe para afatit nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të lejuara me Planin rregullues urban për atë pjesë.

Neni 5

Me realizimin e Planit Planit Rregullues Urban Urban Kuadranti F.6.2 të Qytetit të Prizrenit nr. 01/011-12652, të datës 15 nëntor 2012, Komuna e Prizrenit do të realizojë interesin e vet publik, ashtu që do ta implementoj në tersi Planin Urbanistik nr. 01/011-12652, të datës 15 nëntor 2012, dhe do të përfitoj hapësira banesore me të cilën gjë do të përfitojnë qytetarët dhe komuna.

Neni 6

Konkursi publik do të shpallet në pajtim me ligjet që janë në fuqi, në mediet publike në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në territorin e komunës së Prizrenit dhe do të jetë e hapur së paku 45 ditë nga dita e shpalljes.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës Zyra e prokurimit dhe Shërbimi Pronësoro-juridik. Procedurat e mëtejme për dhënie në shfrytëzim të pronës sipas këtij vendimi do të vazhdojnë sipas procedurave të parapara me ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Neni 8


Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jenë: Vendimi për miratimin e Urban Urban Kuadranti F.6.2 të Qytetit të Prizrenit nr. 01/011-12652, të datës 15 nëntor 2012, skica e gjëndjes në teren dhe Certifikatat e pronësitë cekura në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi kopja e Planit i për sipërfaqet e cekura në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Sektori i Pronës dhe Avokati Publik Komunal.

Neni 9

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe do të shpallet në "Kumtar".

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr: 01/011-4972
Më: prill 2013
Prizren



Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu